



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 11925 Prot

Lezhë, më 02 / 11 /2022

VENDIM

Nr. 115, Datë 31 . 10 .2022

Për përdorimin e Fondit të Kontigjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2022

Në zbatim të nenin 54, të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit Nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi:

1.Miratimin e përdorimit të Fondit të Kontigjencës në shumën 1,200,000 lekë, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2022, për këtë të kryhen veprimet si më poshtë:

- Pakësohet : Gr.00, Prog.01110, Kap.01, Art.609 për shumën 1,200,000 lekë.
- Shtohet : Gr.00, Prog.08130, Kap.01, Art.602 për shumën 1,200,000 lekë, fond i cili do të përdoret për mbulimin e shpenzimeve për Shoqatën e Basketbollit Eagles Basket për periudhën Tetor – Dhjetor.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI
NDUE LULI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 799/9 Prot.

Lezhë, më 11 . 11 .2022

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : **KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut, neni 9, pika 1/1.3, gërma "b", neni 35, pika 4, neni 54, gërma "f" të Ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" Ligjin nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të Vendimit nr. 115, datë 31.10.2022 "Për përdorimin e Fondit të Kontigjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2022".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

